

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

EDEBI I TË USHQYERIT

Imam Gazali

Prishtinë, 2017

Ihjau Ulumid-din
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i origjinalit
Kitâbu adabi'l-ekl
Libri 11

Përgatiti dhe përktheu:
Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

PARATHËNIE

Falënderimi (hamd) i takon vetëm Allahut Teala, që krijoi tokën dhe qiejt. Ai drejton shiun në mënyrën më të bukur për të nxjerrë prej dheut ushqimin e tërë krijesave të gjalla dhe për të lehtësuar veprimet e robërve të devotshëm (salih) me ushqim hallall.

Salat dhe selam deri sa të ekzistojë kjo gjithësi poseduesit të muxhizes së qartë, Muhammedit s.a.v.s., ehli bejtit dhe as'habëve të tij.

Pas kësaj dije se, synimi i vërtet i të mençurve dhe evliave është arritja Allahut në xhenet. Kjo është e mundur vetëm me dituri dhe veprim, ndërsa dituria dhe veprimi bëhet me trup të shëndoshë. E shëndeti dhe selameti i trupit është i lidhur me të ushqyerit në intervale të caktuara kohore. Për këtë arsye, disa robë të devotshëm (salih) e kanë llogaritur të ushqyerit si domosdoshmëri të fesë, dhe si dëshmi kësaj Allah Teala thotë:

“Hani atë që është e lejuar dhe e mirë dhe bëni vepra të mira.” 23-Muminun: 51

Ai që dëshiron të mësojë diturinë për të vepruar dhe për të arritur në devotshmëri, nuk duhet të ha shumë, dhe të ushqyerit e tij duhet të jetë përshtatshëm një rregulli. Sepse çdo gjë që bëhet në emër të fesë duhet të ndriçohet nga drita (*nur*) e fesë. E këto drita janë sunneti dhe rregullat e sjelljes, që edukojnë njeriun. Dhe ani pse me ngrënie plotësohet një kënaqësi e nefsit, kur të ushqyerit peshohet me sheriat, robi shpërblehet posaçërisht. Ndërsa Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Personi merr sevap prej plot gjërave. Bile merr sevap edhe prej kafshatës që e ha dhe asaj me të cilën ushqen familjen.”

E kjo është e mundur me respektimin e rregullave (adab)¹ dhe detyrave në ushqim dhe ngrënie. Ne do të shpjegojmë detyrat e fesë, farzet, sunnetet, edebin, këshillat dhe mirëbërjen lidhur me të ushqyerit.

¹**Adab [sh. Edeb]:** metodë; rrugë; rregullat e sjelljes; edukim; ahlak i bukur; urtësi;

EDEBI I TË NGRËNIT VETËM

Kjo studiohet në tri pjesë: para, gjatë dhe pas ngrënies.

EDEB I PARA NGRËNIES

Këtu ka shtatë rregulla:

Rregulli i parë: ushqimi duhet të jetë hallall, siç kemi shpjeguar në librin *“Hallalli dhe Harami”*, por edhe mënyra e fitimit të atij ushqimi duhet të jetë në përputhje me sheriatin, pastër, dhe larg nga dyshimet.

Allah Teala ka urdhëruar ushqimin e fituar hallall dhe largimin nga harami, e duke shpjeguar rëndësinë e largimit nga harami, thotë:

“O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete, dhe mos mbytni veten tuaj.”

4-Nisa: 29

Pika kryesore dhe më e rëndësishme lidhur me ushqimin, është që ai ushqim të fitohet pastër, pa asnjë dyshim.

Rregulli i dytë: larja e duarve. Lidhur me këtë, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Larja e duarve para ngrënies largon varfërinë, e larja e tyre pas ngrënies, largon gjynahet.”

E në një transmetim tjetër është thënë:

“Larja e duarve para dhe pas ngrënies largon varfërinë.”²

Duart nuk mund të shpëtojnë nga papastërtia për shkak se janë vazhdimisht në kontakt me diçka. Pastrimi është edukatë, e në të njëjtën kohë - meqë të ushqyerit është edhe ibadet - me këtë zbatohet edhe një detyrë e fesë. Për këtë arsye larja e duarve para ngrënies llogaritet si abdes i namazit.

Rregulli i tretë: gjella duhet të vendoset në shtrojë e shtrirë në tokë. Kjo është më përshtatshëm sunnetit të Resulallahut s.a.v.s., sepse Resulallahu s.a.v.s., ashtu ka ngrënë. Ngrënia në këtë pozitë është më afër modestisë. Nëse kjo është e pamundur, atëherë ushqimi vendoset në sofër. Sofra të kujton udhëtimin (*sefer*), e udhëtimi të kujton rrugën e ahiretit dhe devotshmërinë në atë rrugë. Enes b. Malik r.a., ka thënë se Resulallahu s.a.v.s., nuk ka ngrënë në sofër. E kur e pyetën:

- *Ku keni ngrënë?*, tha:

- *Mbi shtrojnë, përtokë.*

² Taberani në veprën **‘Evsat’**, nga Ibn Abbasi r.a.

Thuhet që pas Resulallahut s.a.v.s., katër gjëra janë risi: sofa, sita, çogeni³ dhe ngopja (ngrënia e tepërt).

Mirëpo dije se: kur ne themi që ngrënia në tokë mbi shtrojë është më e vlefshme, nuk po themi që ngrënia në sofër a tavolinë është haram ose e papëlqyer (mekruh). Në këtë çështje nuk ekziston ndonjë ndalim i argumentuar, e thënia: *“kjo është risi pas Resulallahut s.a.v.s.”*, nuk nënkupton që ajo është edhe bidat, dhe për këtë nuk do të duhej të jetë e ndaluar. Ngase ‘risi’ nuk nënkupton ‘e ndaluar’. Risi e ndaluar është risia (bidati) që kundërshton një sunnet të argumentuar dhe në vazhdimësi dëmton a anulon ndonjë vendim të sheriatit. Bile, me ndryshimin e kushteve, në ndonjë rast risia mund të bëhet edhe e domosdoshme (vaxhib). Për lehtësim, gjella mund të ngritet më lartë, në sofër ose tavolinë.

Risi të këtilla nuk duhet përbuzur. Katër risitë e përmendura bile as nuk janë në nivel të njëjtë:

Pastrimi është i lavdërueshëm (mustehab), ndërsa çogeni pastron shumë mirë. Ndoshta njerëzit nuk e kanë përdorur më parë sepse as nuk kanë ditur për të, ose kanë qenë të angazhuar në çështje edhe më me rëndësi se pastrimi, e në ato kushte duart vetëm i kanë fshirë me çogen ose për tabanin e këmbës. Një veprim i tillë i tyre nuk do të thotë që ndalon pastrimin me ujë, e që është e lavdërueshme (mustehab).

³Bimë që është përdorë për pastrimin e duarve.

Sita përdoret për ta bërë bukën dhe gjellën më mirë, e nëse nuk teprohet – është mubah.

Megenëse ngrënia edhe është më e lehtë në sofër ose tavolinë se sa në tokë, atëherë kjo është mubah, nëse nuk shkon deri në mendjemadhësi.

Më e keqe se këto të tria është ngrënia e tepërt, sepse kjo e gjallëron epshin.

I mençuri lehtë e kupton dallimin mes këtyre risive.

Rregulli i katërt: ulja në sofër me edukim (adab) dhe këtë adab ta ruajë deri në fund. Resulallahu s.a.v.s., nganjëherë ulej këmbëkryq, nganjëherë ulej ashtu siç ulet në namaz dhe nganjëherë në këmbën e majtë duke përdredhur këmbën e djathtë, dhe thoshte:

“Unë nuk ha mbështetur. Unë jam rob. Ha si rob e ulem si rob.”

Pirja e ujit mbështetur është e papëlqyer (mekruh) nga pikëpamja e fesë, por edhe e dëmshme për stomak. Edhe të ngrënit mbështetur është mekruh, përpos nëse janë kokrra që mbahen në dorë. Sipas transmetimit, hazreti Alia kerremallahu vexh’he ka ngrënë gurabia mbështetur në mburojë. Thuhet se arabët kështu veprojnë.

Rregulli i pestë: ngrënia e ushqimit duhet të jetë për mbledhjen e fuqisë për të adhuruar Allahun - pra për

ibadet, jo për të plotësuar kënaqësitë. Bile, Ibrahim b. Shejbani ka thënë:

- *Ka tetëdhjetë vite që nuk kam ngrënë për të plotësuar kënaqësitë e epshit tim.*

Besimtari duhet të përpiqet të hajë pak, sepse kështu kuptohet a po ha me nijetin (qëllimin) e ibadetit. Ngrënia e tepërt e pengon njeriun në ibadet sepse ibadeti nuk mund të bëhet me barkun plot. Nijet i ngrënies së paktë për ibadet është edhe thyerja e epshit dhe preferimi i të mjaftueshmes ndaj tepërcës. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ena më e keqe që e mbush njeriu është stomaku i vet. Birit të Ademit i mjaftojnë disa kafshatë që të drejtohet. Nëse me këtë nuk kënaqet, le ta ndajë barkun në tri pjesë: një pjesë për ushqim, një për ujë dhe një pjesë le ta lë për ta marrë frymë.”⁴

Një nga nijetet e ngrënies për ibadet është që të mos hahet deri sa të ndjehet uria. Robi duhet që patjetër të ketë uri, e më pas të hajë. E pastaj, pa e mbushë barkun, ta ndërpresë. Atij që kështu vepron, nuk i nevojitet mjeku.

Në vëllimin e tretë ***Rub’u’l-Muhlikat*** do të shpjegohen dobisht nga të ngrënies së paktë (racioni i vogël), si edhe mënyrat e zvogëlimit gradual të racionit.

⁴E transmeton Tirmidhi dhe thotë që është *hasen*. Transmetojnë edhe Nesai, Ibn Maxhe dhe Mikdad b. Ma’di nga Kebiri r.a.

Rregulli i gjashtë: të mjaftuarit me ushqimin që është gati dhe mos-kërkimi i shumëllojshmërisë. Mos kërkimi i gjellës është respekt ndaj bukës. E ne jemi urdhëruar të respektojmë bukën. Çdo ushqim që të mban në këmbë dhe të jep mundësi për të bërë ibadet është bereqet i pastër; prandaj nuk është e drejtë të mos pëlqehet. Nuk duhet të kërkohet tjetër ushqim prej asaj që është gati, por atë duhet ngrënë. E kur gjen ushqimin gati, edhe nëse është koha e namazit, së pari ha, pastaj fal namazin. Sepse me një hadith thuhet:

“Kur namazi dhe ushqimi bashkohen në një kohë, së pari hani pastaj falni.”⁵

Bile, Abdullah b. Omeri r.a., edhe kur dëgjonte leximin e imamit, nuk çohet nga sofa. Por kjo është në kohën e urisë. Nëse nuk ekziston ndonjë pengesë për pritje në ushqim, atëherë fal namazin e pastaj ha në rehati. Por nëse ekziston frika që ushqimi mund të ftohet ose priset, atëherë duhet të preferojë ushqimin. Sepse hadithi është parim i përgjithshëm, dhe nëse njeriu është shumë i uritur, ai do ta mendojë ushqimin edhe duke falë namazin.

Rregulli i shtatë: ngrënia së bashku, me tërë familjen. Në hadith thuhet:

“Hani së bashku, kjo ju bëhet bereqet.”⁶

⁵ Është cekur në librin e namazit.

⁶ Ebu Davud dhe Ibn Maxhe nga Vashi b. Hari r.a.

Enesi r.a., na njofton se Resulallahu s.a.v.s., nuk ka ngrënë vetë. Me një hadith tjetër Resulallahu s.a.v.s., thotë: **“Ushqim i hairit është ushqimi që hahet në kallaballëk.”**⁷

EDEBI GJATË NGRËNIES

Të fillohet me bismilah dhe të përfundohet me hamd. Bile, të thuhet ‘bismilah’ në çdo kafshatë është më mirë. E, edhe më mirë është që në kafshatën e parë të thuhet ‘bismilah’, në të dytën ‘bismilahi-rrahman’ e në të tretën ‘bismilahi-rrahmani-rrahim’. Bismilahi thuhet më zë, për ta dëgjuar të tjerët dhe ta thonë edhe ata. Të hahet me dorë të djathtë, me kripë të fillohet dhe me kripë të përfundohet. Kafshata të jetë e vogël, mirë të përtypet, dhe pa kapërdi njëhën nuk duhet të marrë tjetër. Sepse kjo është ngutje në ngrënie.

Nuk duhet të qortohet ushqimi. Resulallahu s.a.v.s., nuk ka qortuar asnjë ushqim. Nëse i pëlqen e ha e nëse nuk i pëlqen nuk e ha. Të hajë para vetes, përpos kur bëhet fjalë për fruta; ato mund edhe të zgjidhen, ngase një veprim i tillë nuk neverit. Pasi që në hadith thuhet:

“Ha para vetes”⁸, kur Resulallahu s.a.v.s., zgjodhi një frutë, e pyetën: *Si bëhet kjo?*, e Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Fruti nuk është si ushqimi.”⁹

⁷ Haraiti në **‘Mekarim-ul Ahlak’**

⁸ Buhariu dhe Muslimi nga Omer b. Ebu Selemi.

⁹ Tirmidhi, Ibn Maxhe nga Ikreshi.

Bukën dhe gjellën nuk duhet ngrënë nga mesi por nga anët. Nëse është copë më e madhe e bukës, nuk duhet prerë por të ndahet me dorë. As mishin e pjekur nuk duhet prerë; Resulallahu këtë e ka ndaluar. Ushqimi hahet me kafshim. Mbi bukë nuk duhet vendosur enë a lugë. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Respektoni bukën; Allah Teala e ka zbritur atë nga bereqeti i qiejve.”

Nuk duhet fshirë dorën me bukë. Në një hadith, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Nëse i bie një kafshatë ndonjërit nga ju, le ta marrë atë kafshatë, ta pastrojë dhe ta hajë, mos t’ia lë atë shejtanit, dhe pa i lëpirë gishtat mos t’i prekë rrobat; njeriu nuk e di se nga cila pjesë e ushqimit vjen bereqeti.”¹⁰

Nuk është e lejuar të fryhet në gjellë për ta ftohur atë, por duhet pritur deri sa të ftohet. Hurma duhet të hahet nga një, tre, pesë...gjithnjë tek. Thelbi i tyre nuk duhet të vendoset në enën ku janë hurmat, por prej gojës duhet vendosur në dorë, e më pas të hedhen. Kështu duhet vepruar me çdo pemë me thelb. Frutat e kalbur nuk vendosen prapë në enën me fruta. Gjatë ngrënies nuk duhet pirë shumë ujë, përpos sipas nevojës. Kurse pirja e ujit në rast të etjes së madhe është e mirë edhe për shëndet, sepse uji e pastron stomakun, kanë thënë.

¹⁰ Muslimi nga Enesi dhe Xhabiri r.a.

EDEBI I UJIT

Uji pihet me dorën e djathtë, duke thënë bismilah, dhe jo përnjëherë, ngase Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Pini ujin me gllënjka, mos pini përnjëherë. Sëmundja e mushkërive vjen si pasojë e kësaj.”¹¹

Ujin duhet pirë ulur, jo në këmbë ose mbështetur. Resulallahu s.a.v.s., nuk e ka lejuar një veprim të tillë. Megjithëkëtë, ka raste kur ka pirë edhe në këmbë, e kjo sigurisht me arsye. Besimtari duhet të ketë kujdes të mos pikoj ujë nga gota në trup dhe të shikojë ujin në gotë. Resulallahu s.a.v.s., ka këshilluar që, kur e largon gotën nga goja, të thuhet:

“Hamd i qoftë Allahut Teala që krijoi ujin e ëmbël dhe të mirë, e nuk e bëri atë të hidhur, si pasojë e kryengritjes tonë.”¹²

Kur shpërndanë ujë në një tubim, gota duhet të jetë në dorën e djathtë dhe t’i jepet personit nga ana e tij e djathtë. Kur Resulallahu s.a.v.s., pinte një gllënjë qumësht ose sherbet, gjithmonë ia jepte gotën tutje personit nga ana e tij e djathtë. Gota vazhdimisht shëtitet nga e djathta, e në anën e djathtë të Resulallahut s.a.v.s., zakonisht ishte hazreti Ebu Bekri r.a. Një ditë, një beduin e gjeti zbrazët vendin e Ebu Bekrit

¹¹ Ebu Mensur ed-Dejlemi ne veprën *‘Musnedul-firdevs’*.

¹² Taberani në librin *‘Dua’* nga Ebu Xhaferi r.a.

r.a., dhe u ul aty. Kur erdhi Ebu Bekri, e pa që beduini ishte ulur në vendin e tij, dhe u ul në një vend tjetër. Në atë moment, Resulallahut a.s., ia dhanë një gotë qumësht, dhe si çdoherë, pas një gllënjke ai a.s., e vazhdoi gotën në anën e djathtë. Duke e ditur epërsinë e Ebu Bekrit, hazreti Omeri r.a., e përkujtoi Resulallahun a.s., për t'ia dhënë gotën Ebu Bekrit, e në këtë Resulallahu a.s., tha:

“Nga e djathta”,

dhe ia dha gotën bedunit që ishte në anën e djathtë.

Ujin duhet pirë me tri gllënjka. Fillon me bismilah, kurse pas gllënjës së parë thuhet: ‘Elhamdulilah’, pas të dytës: ‘Elhamdulilahi Rabbi’l-alemin’ dhe pas të tretës: ‘Elhamdulilahi Rabbi’l –alemin er-Rahmani’r-Rahim’.

Shpjegimet që i dhamë lidhur me të ushqyerit përfshijnë rreth njëzet edebe, e për këtë ekzistojnë hadithe, si edhe fjalët dhe veprat e as’habëve.

EDEBI PAS NGRËNIES

- Largimi nga sofrë pa u mbushur barku.
- Nuk duhet fshirë duart me leckë deri sa nuk

lëpihen gishtat mirë.

- Troshat duhet ngrënë. Resulallahu s.a.v.s., me një hadith thotë:

“Ai që ha troshat e bukës, nuk do të ketë vështirësi, fëmia i tij nuk bëhet i paditur.”¹³

- Thuhet se ngrënia e troshave të bukës në sofër është mihri¹⁴ i Hyrive të Xhennetit.

- Duhet pastruar dhëmbët, dhe ajo që del nga dhëmbët nuk duhet gëlltitur, përpos asaj që e merr me gjuhë, dhe pastaj të shpërlahet goja.

- Duhet falënderuar Allahun për ushqimet që i ka dhënë. Allah Teala thotë:

“Hani nga të mirat që ua kemi dhënë dhe falënderoni Allahun.” 2-Bekare: 172

- Pas ngrënies nga fitimi hallall, duhet bërë dua kështu:

“Allahut i qoftë hamd; vetëm me të mirat që na jep Ai plotësohen mirësitë dhe zbret bereqeti. O Allah, na mundëso të fitojmë ushqim hallall dhe të bëjmë vepra të mira.”

¹³ Ebu Shejh në librin e tij *‘Kitabu’s-Sevab’* nga Xhabiri r.a.

¹⁴ Mihr: Pasuri dhënë bashkëshortes.

Nëse ushqimi i ngrënë është i dyshimtë, duaja bëhet kështu:

“Në çdo gjendje falënderoj Allahun. O Allah, këtë ushqim mos na e bëj forcë që na dërgon në kryengritje.”

- Pas ushqimit të lexohen suret ‘Kurejsh’ dhe ‘Ihlas’.

- Mos të ngritet pa u larguar sofrë.

- Nëse ka ngrënë ushqimin e të tjetrit, atëherë për të lutet:

“ O Allah, shtoja këtij personi bereqetin dhe le ta shfrytëzojë në të mirë. Atë dhe mua na bëj prej falënderuesve, dhe të kënaqur.”

- Kur bën iftar me një xhemat, të bëj dua:

“Ky ushqim u bëftë iftar i agjëruesve, le të jetë sofër e të mirëve, melaqet për ju bëfshin istigfar.”

Kur ha kafshatë të dyshimtë duhet të bëjë istigfari, të brengoset, dhe të mundohet ta shuaj zjarrin e xhehenemit me lot. Sepse Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Çdo mish që është bërë nga ushqimi haram, e meriton zjarrin.”¹⁵

Me siguri që nuk është i njëjtë ai që qan dhe brengoset pas kafshatës së dyshimtë me atë që ha dhe argëtohet.

Kur pi qumësht, duhet të thotë:

“O Allah! Bëje këtë qumësht bereqet për ne, dhe shtona riskun,”¹⁶

¹⁵ Bejhakiu në librin e tij *‘Shuabu’l-Iman’* nga Kab b. Axhere r.a.

¹⁶ Ebu Davud dhe Tirmidhi, sipas të cilit hadithi është hasen, si dhe Ibn Maxhe nga Ibn Abbasi r.a.

E nëse ha diçka tjetër, duhet të thotë:

“O Allah! Bëje këtë ushqim të dobishëm për ne dhe na dhuro bereqet të hairit.” Pas ushqimit mustehab të thotë:

“Hamd i qoftë Allahut, Rabbit tonë, që na ushqen, na gëzon dhe na strehon. Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. O Allah, na ushqen pas urisë dhe na jep siguri pas frikës, hamdi të qoftë Ty! Ti shpëton nga vështirësitë, udhëzon të humburin, nxjerr nga varfëria, prandaj hamd i pafund qoftë për Ty, ashtu siç të takon. O Allah, na ushqeve me ushqim të shijshëm, prandaj na bëj edhe neve të mirë, dhe bëj që ky ushqim të na bëhet forcë në rrugën e nënshtrimit ndaj Teje, dhe te Ti kërkojmë strehim që ajo të mos na bëhet mbështetje për kryengritje ndaj Teje.”

EDEBI E NGRËNIES RRETH SOFRËS

Janë shtatë prej tyre:

1. Nëse në sofër është dikush më i moshuar dhe më i nderuar se vetë, atëherë nuk duhet ta fillojë ngrënien para tij. Nëse vetë është në këtë gradë atëherë duhet ta fillojë menjëherë, që të tjerët të mos presin.

2. Nuk duhet të hesht në sofër siç është adeti i Persianëve, por mund të tregojë veprimet e të devotshmëve, rreth ushqimit ose çështje të tjera.

3. Në ngrënie të përbashkët, duhet të ketë kujdes të mos hajë më shumë se shoku, sepse ata janë të barabartë në ushqim, prandaj të hahet më shumë pa pëlqimin e shokut, nuk është e lejuar. Bile, duhet preferuar shokun. Nuk duhet të marrë dy hurma përnjëherë, pos nëse të gjithë hanë ashtu ose i lejohet, e atëherë nuk ka zarar. Nëse shoku nuk ka oreks, duhet inkurajuar, duke thënë: *‘Urdhëro ha’*, por jo më shumë se tri herë, sepse përmbi tri herë është insistim i panevojshëm dhe teprim. Resulallahu s.a.v.s., tri herë insistonte, më shumë jo, prandaj të lutet përtej kësaj është dalje prej edebit. Assesi nuk duhet thënë: *‘Për rizanë e Allahut eja ha’*, sepse kjo është e ndaluar. Hazreti Hasani r.a. i biri i Aliut r.a., ka thënë:

“Mysafirrit nuk duhet t’i bëhet be ne çështje të ushqimit.”

4. Nuk duhet të bie në atë gjendje e që shoku t’i thotë: *“Urdhëro, ha”*. Nuk duhet privuar veten nga ai ushqim që ia do shpirti, vetëm pse dikush e shikon; kjo është një sjellje artificiale. Si ha kur është vet, ashtu duhet ngrënë edhe kur është me xhemat. Por, nëse ha më pak për të ndihmuar shokët, kjo sjellje është e mirë. Me lejen e atyre që janë rreth sofrës dhe për t’i kënaqur ata, nuk ka pengesë nëse ha edhe më shumë se sa e ka adet kur është vet, ndoshta kjo bile është edhe më e mirë. Ibn Mubarek, frutat më të mira ua ofronte mysafirëve dhe thoshte: *“Kush ha më shumë do t’i jap*

për çdo farë nga një dërhëm, si qira për dhëmbët”, dhe vërtet, atij që hante më shumë i jepte nga një dërhëm për secilën farë. Këtë e bënte për t’ua lehtësuar gjendjen mysafirëve dhe për t’ju shtuar disponimin. Xhafer b. Muhammed r.a., ka thënë: “Nga shokët, më së lehti e kam me ata që hanë më shumë, e më së vështiri me ata që më detyrojnë t’ju them: ‘merr, ha.’” Të gjitha këto veprime bëhen për të larguar sjelljet artificiale dhe për ta bërë të thjeshtë ngrënien e ushqimit. Xhaferi thotë: “Dashuria ndaj shokut kuptohet me ngrënien lirshëm të ushqimit në shtëpinë e tij.”

5. Larja e duarve në legen nuk ka zarar. Kur ha vetë, personi mundet edhe ta shpërlajë gojën në atë legen, por kur është me të tjerët, këtë duhet evituar. Kur dikush i ofron legenin për t’i larë duart, duhet të pranojë. Enes b. Maliku dhe Sabit Benaniu, po hanin nga e njëjta enë. Pastaj Enesi e morri legenin dhe ujin, që Sabiti të lajë duart, por ky nuk pranoi, e Enesi tha: “*Hyzmeti nuk refuzohet, ajo është për rizanë e Allahut.*”

Harun Rashid, halife i Abasinëve, një ditë e ftoi mysafir Ebu Muavije ed- Daririn,¹⁷ ia ofroi legenin me ujë për t’i larë duart dhe i tha:

- *A e di kush po të bën hyzmet?*
- *Nuk e di., tha Ebu Muavie, e Harun Rashidi i tha:*
- *Halifeja po të bën hyzmet. Ebu Muaviu ia ktheu:*

¹⁷ Ka humbur shikimin në moshën 40 vjeçare.

- Me këtë veprim i shprehe respekt diturisë dhe e lartësove atë; Allahu ty të lartësoftë.

Larja e duarve në një legen edhe nga disa persona nuk ka zarar. Bile, një veprim i tillë kursen kohën dhe është më afër modestisë. Nëse duart lahen me radhë, nuk ka nevojë që pas secilës larje të zbrazet legeni, mjafton që kjo të bëhet kur legeni të mbushet. E në një hadith është thënë:

“Bashkohuni në pastrim të duarve, që edhe Allahu juve t’ju bashkojë.”¹⁸

Bile, halife Omer b. Abdulazizi lidhur me këtë i njoftoi vilajetet përmes një shkrese zyrtare, ku thotë:

“Mos e zbrazni legenin për secilin që lanë duart, duke iu përshtatur ashtu adetit të persianëve. Kur mbushet legeni, atëherë zbrazeni.” Ibn Mesudi r.a., njëjtë ka thënë: *“Lani duart në një legen, e mos iu përshtatni adeteve persiane.”*

Për hyzmeqarin që e mbanë legenin dhe ujin, disa thonë që është më mirë të qëndrojë në këmbë, të tjerët thonë që duhet të ulet. Një person ishte i ulur, e kur hyzmeqari iu afrua me legen e ujë, ai u ngrit në këmbë, dhe kur e pyetën *“Pse u ngrite?”*, tha: *“Sepse është më e përshtatshme për t’i larë duart, dhe është më e përafërt*

¹⁸ Kudai në *‘Musned-ul Shihab’* nga Ebu Hurejre r.a.

me modestinë.” Hyzmeqari që bën hyzmetin, nëse nijetin e ka për rizanë e Allahut, mund edhe të ulet, që uji të rrjedhë më lehtë.

Sidoqoftë, larja e duarve në legen ka shtatë edebe: (1) të mos pështyhet në legen, (2) së pari t’i lajë duart më i rëndësishmi i mexhlisit, (3) më i rëndësishmi i mexhlisit duhet ta pranojë këtë respekt, (4) pasimi në rreth bëhet kah e djathta, (5) disa vetë përnjëherë t’i lajnë, (6) të mos zbrazet legeni pa u mbushur plot, dhe (7) hyzmeqari të qëndrojë në këmbë.

Gjithashtu është edeb që, ai që bën hyzmetin të ketë kujdes të mos stërpikë uji anash, dhe që pronari i shtëpisë vet t’ia bëjë hyzmetin mysafirrit. Imam Maliku në shtëpinë e tij po mbante legenin me ujë për t’ia larë duart Imam Shafiut, e në atë kohë Imam Shafiu ende nuk ishte njëzet vjeçar. Imam Shafiu u turpërua, e Imam Maliku i tha: *“Mos u çudit. T’i bëhet mysafirrit hyzmet është obligim.”*

6. Gjatë ngrënies nuk duhet të shikohen shokët në mënyrë ofenduese a turpëruese, dhe secili të merret me ushqimin e vet. Nuk duhet ngutur për të braktisur të ngrënit i pari, ngase edhe shokët mund pastaj të nguten për ta braktisur, por, për të ngrënë shokët më shumë, duhet ngrënë pak nga pak. E nëse edhe ashtu ha pak, atëherë duhet që në fillim të hajë më ngadalë, e të

përfundojë së bashku me shokët. Kështu kanë vepruar shumica e as'habëve. E nëse nuk mundet të vazhdojë, duhet t'i njoftojë shokët për shkakun.

7. Nuk duhet bërë sjellje që nuk u pëlqejnë shokëve. Duhet të ketë kujdes si ha, të mos e fus dorën në pjatë, të mos e ul kokën në pjatë, nëse nxjerrë diçka nga goja - të kthehet prej sofrës dhe ta nxjerrë nga goja atë me dorën e majtë. Nuk duhet ta zhyt kafshatën e bukës në vaj e pastaj në uthull, nuk duhet që pjesën e kafshuar ta zhyt në gjellë dhe nuk duhet të flasë fjalë neveritëse.

EDEBI I GOSTITJES

Të gostiten shokët e miqtë është vlerë e lartë. (fazilet). Xhafer bin Muhammed r.a., ka thënë:

- Kur uleni në sofër me shokët, zgjatni uljen, sepse ajo ndejë është pjesë e jetës tuaj për të cilën nuk do të jepni llogari (para Allahut).

Hasan Basriu ka thënë:

- Besimtari do të përgjigjet për ushqimin e vet, të familjes dhe prindërve, por për ushqimin me të cilin gostit shokët dhe miqtë nuk do të përgjigjet. Allahut i vije turp të pyet për këtë.

Hadithe në këtë çështje:

“Deri sa të keni sofrën me ushqim para mysafirit, melaiket bëjnë istigfar për ju.”¹⁹

Njëri nga dijetarët e Horasanit vendoste në sofër më shumë ushqim se që mund të hajë mysafiri, e duke e marrë si arsye këtë hadith:

“Ai që e ha tepricën e asaj që kanë ngrënë shokët, nuk i kërkohet llogari për atë ushqim”²⁰, thoshte:

“Edhe unë vendosi kaq shumë ushqim për mysafirin në sofër, që të ha pastaj tepricën, e të shpëtoj nga përgjegjësia.”

¹⁹ Taberani nga Ajsha r.a.

²⁰ Nuk është gjetur burimi.

E në një hadith tjetër thuhet:

“Robi nuk jep llogari për ngrënien me shokët.”²¹

si edhe:

“Robi nuk jep përgjegjësi për tri ushqime: syfyrin, iftarin dhe ngrënien me shokët.”²²

Për këtë, disa kanë ngrënë pak kur ishin vetëm, e shumë kur ishin me xhemat.

Hazreti Alia r.a., ka thënë:

- Për mua, më e dashur është ngrënia e një porcioni bashkë me shokët se sa lirimi i një skllavi.

Abdullah bin Omeri r.a., ka thënë:

- Të merret ushqim i bollshëm në udhëtim për të qeras shokët, është nder dhe bujari.

As’habët kanë thënë: “Mbledhja në një sofër, është nga vlerat e larta të karakterit (ahlak).” Ata mblidheshin për të lexuar Kur’anin, dhe kur përfundonin, nuk ndaheshin pa ngrënë ndonjë ushqim të lehtë. Është thënë që organizimi i mbledhjeve të tilla me shokët në një atmosferë të singertë, nuk është dynjallëk por është veprim për ahiret.

²¹ Hadithi vazhdon poshtë.

²² Exhi në veprën ‘**Zuafa**’ nga Xhabiri r.a.

E në hadithe është thënë:

Në ditën e kiametit, Allah Teala i thotë robtit:

- *Unë kisha uri, ti nuk më ushqeve.* Personi habitet:

- *O Rabb, Ti je Rabb i botëve, si mundem unë të Të ushqej?*, e Allah Teala i thotë:

- *Të erdhi vëllai besimtar i uritur, ti nuk e ushqeve.*

***Po ta kishe ushqyer, sikur të më kishe ushqyer Mua*.²³**

“Kur t’ju vjen mysafiri, gostiteni.”²⁴

“Në xhenet ekzistojnë pallate të tejdukshme; nga brenda u shihet e jashtëmja e nga jashtë e brendshmja. Këto janë për atë që flasin butë, ushqejnë njerëzit, dhe natën, kur të tjerët janë në gjumë, ata falin namaz.”²⁵

“Më i hairit nga ju është ai që ushqen të tjerët.”²⁶

“Allah Teala e largon pesëqind vjet dhe me shtatë hendeqe nga xhehenemi personin që ushqen vëllain deri sa të ngopet, dhe i jep për të pirë deri sa të shuaj etjen.”²⁷

Kurse edebe të gostitjes janë dy: edebi i mysafirit dhe ai i mikpritësit.

²³ Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

²⁴ Haraiti në ‘*Mekarim-ul Ahlak*’ nga Enesi r.a. dhe Ibn Ebi Hatem në ‘*ilel*’ nga babai i tij.

²⁵ Tirmidhi nga Alia r.a.

²⁶ Ahmedi dha Hakimi nga Suhejbi r.a.

²⁷ Taberani nga Abdullah b. Omeri r.a.

EDEBI I MYSAFIRIT

Nuk është e drejtë të shkohet në vizitë në kohën e ushqimit (vakti i kafjallit, drekës ose darkës). Vizita e tillë është e ndaluar. E në Kur’ani Kerim thuhet:

“O ju që besuat, mos hyni në shtëpitë e Pejgamberit, përveç nëse u lejohet juve për të ngrënë, por jo të pritni përgatitjen e tij (ushqimit).”

33-Ahzab:53

Pra, nuk shkohet në vizitë në kohën e përgatitjes së ushqimit. Në një hadith thuhet:

“Ai që shkon në sofër në të cilën nuk është i ftuar, siç është gjynahqar për shkuarje, edhe ngrënien e ka haram.”²⁸

Por, nëse ndodh që personi shkon në vizitë pa u kujdesur për kohën, dhe rastësisht qëllon në sofër, nuk duhet të ulet deri sa ta ftojë. Kur i thonë ‘*urdhëro*’, duhet ta shikojë gjendjen e tyre; nëse ftesa është nga zemra atëherë e pranon ftesën, e nëse ftesa nuk është nga zemra por vetëm si mirësjellje, nuk ulet, dhe kërkon ndjesë duke thënë se është i ngopur.

Nuk ka zarar nëse personi i uritur shkon te shoku me qëllim për të ngrënë e pa u kujdesur për kohën e ngrënies. Bile, Resulallahu s.a.v.s., me Ebu Bekrin r.a., dhe Omerin r.a., kanë shkuar te Ebu’l-Hajsemi dhe Ebu

²⁸ Bejhakiu nga Ajsha r.a.

Ejjub el-Ensariu vetëm për të ngrënë, kur kanë pasur uri. Të shkohet te vëllai musliman me qëllim që ai vëlla të përfitojë shpërblimin e ushqimit, është ndihmë shpirtërore. Ky ishte adeti i Selefëve. Avn b. Abdullah el-Mesudi kishte 360 shokë, dhe gjithë vitin e kalonte me ta, duke shkuar çdo ditë te ndonjëri për të ngrënë. Dikush tjetër kishte 30 shokë dhe te secili shkonte nga një herë në muaj. E një tjetër kishte 7 shokë, dhe te secili shkonte nga një herë në javë. Shokët e dinin këtë dhe përgatiteshin, duke e llogaritur këtë si ibadet.

Bile, nëse mysafiri nuk e gjente shokun (pronarin e shtëpisë) aty, meqenëse ishte i bindur në besnikërinë e tij dhe që shokut do t'i bëhej qejfi, hante nga ushqimi i tij, e pastaj largohej. I urituri ha në shtëpinë e shokut pa marrë leje prej tij. E shumica japin leje me gjuhë, por jo me zemër. Të tillëve me u ngrënë ushqimin është mekruh (e papëlqyeshme). Por, të hahet te shoku i cili nuk është prezent dhe nuk mundemi të marrim leje prej tij, është mirësi. Ndërsa në Kur'an, njëra prej shtëpive ku është lejuar ngrënia lajmërohet kështu:

“...ose (në shtëpi) te miqtë e singertë.”24-Nur: 61

Pra, edhe teveqel të jetë, në shtëpinë e tyre mund të hajë. Bile, Resulallahu s.a.v.s., një ditë shkoi pa lajmëruar në shtëpinë e Berires (skllavja e liruar nga Ajsha r.a.), e ajo ia shtroi një gjellë me mish, që ia kishin dhuruar asaj. Resulallahu s.a.v.s., hëngri, e duke u larguar tha: **“Dhurata e gjeti vendin e vet”**, sepse e dinte

që me këtë Berire do të jetë e kënaqur. Prandaj është e pranueshme (xhaiz) për të hyrë në shtëpinë e shokut, por vetëm nëse e di sigurt se ai do të jepte leje. Në të kundërtën, nuk duhet hyrë në shtëpi të huaj pa marrë lejen e sigurt.

Muhammed bin Vasiu dhe shokët të tij hynin pa leje në shtëpinë e Hasan Basriut dhe ushqeheshin me atë që gjenin aty. Kur Hasan Basriu kthehej dhe i gjente duke ngrënë, gëzohej, e thoshte: *“Kështu na pëlqen”*. E vet Hasan Basriu, një ditë po merrte nga një kokërr frutash prej një dyqani. Hishami e pyeti:

- *O Ebu Said! Tij që je aq i kujdesshëm në devotshmëri, ç’është kjo?* Hasan Basriu i tha:

- *Lexo në Kur’an ajetin për ushqimin (‘ekil’).*

Kur Hishami e lexoi ajetin:

“...ose (në shtëpi) te miqtë e singertë”,

Hasan Basriu i tha:

- *Pra, ushqimi i mikut hahet.* Hishami e pyeti:

- *Kush është i singertë?* Hasan Basriu i tha:

- *I singertë është ai kah i cili të anon zemra dhe me të cilin zemra të gjen qetësi.*

Një xhemat shkoi në shtëpinë e Sufjan Sevriut por nuk e gjetën në shtëpi. Ata e çelen derën, hynë brenda, e shtruan sofrën dhe filluan të hanë. Në një moment Sufjan Sevriu hyri brenda, e kur i pa, tha:

- *Sa mirë keni vepruar. Më përkujtuat ahlakun e selefëve. Ata kështu kanë bërë.*

Një tjetër xhemat e vizituan një person nga taibinët, e ky nuk kishte asgjë për të vendosur në sofër. Menjëherë shkoi te komshiu, por nuk e gjeti në shtëpi. Në tenxhere kishte gjellë, e në dollap kishte bukë. Morri çka gjeti dhe ua shtroi mysafirëve. Kur u njoftua për këtë i zoti i shtëpisë, tha:

- *Shumë mirë ke bërë. Nëse prapë vinë, prapë, pa drojë njëjtë vepron.*

Qe, ky është edebi i mysafirit.

EDEBI I MIKPRITËSIT

1. Edebi i parë është shërbimi pa harxhime. Në sofër duhet shtruar atë që ka në shtëpi. Nëse nuk ka asgjë e as nuk ka para, nuk duhet të marrë borxh për këtë. E nëse ka ushqim vetëm sa për nevojën e vet, nuk është i detyruar të ushqejë të tjerët. Një zahid po hante ushqimin që e kishte marrë me borxh, hyri një person, e besimtari i tha:

-*Po të mos e kisha marrë këtë ushqim me borxh, edhe ty të kisha dhënë, por me borxh nuk mundem të të ushqej.*

Më lartë thamë që nuk duhet bërë harxhime për të ushqyer mysafirin. E harxhim është ajo me çka ti e ushqen mysafirin e nuk ke mundësi ta hash për vete.

Fudajli ka thënë:

- *Njerëzit po largohen mes vete për shkak të harxhimeve. Shoku viziton shokun, e kur sheh mundimin dhe harxhimin që shoku ka bërë për të, nga modestia herën tjetër nuk shkon, dhe kështu fillon ndarja.*

Dikush ka thënë:

- *Unë nuk brengosem se cili nga shokët më vjen, sepse unë nuk hyj në harxhime për ta, gostit me atë që kam. Po të shpenzoja për ndonjërin, herën tjetër nuk do të doja të më vinte.*

Një person vizitoi shokun, e kur pa harxhimet e panevojshme të shokut, i tha:

- *O mik, pse gjithë ky harxhim? As ti e as unë nuk ushqehemi me këto kur jemi vet. Ose ndale këtë harxhim, ose unë nuk do të vij më.*

Shoku e ndërpreu harxhimin dhe miqësia vazhdoi.

Harxhim është edhe kur gjithë ushqimi që është në shtëpi i shtrohet në sofër mysafirit, e familja futet në vështirësi. Transmetohet se njëri e ftoi në shtëpinë e vet hazreti Alinë r.a., e Alia r.a., i tha:

- *Pranoj ftesën me tri kushte: nuk do të blesh asgjë nga tregu për mua, nuk do të përgatitet asgjë posaçëm për mua, dhe, nuk do të shtrosh gjithë çfarë ke në shtëpi për mua, e familjen ta shqetësosh.*

Disa nga Selefët sillnin çdo lloj ushqimi prej asaj që kishin në shtëpi, dhe kështu gostitnin mysafirin.

Xhabir b. Abdullahut i erdhën mysafirë, e ai vendosi bukën dhe uthullën në sofër, dhe tha:

-Po të mos na ishte ndaluar harxhimi, do të isha harxhuar dhe do të përgatisja edhe ushqime tjera.

E një person kishte thënë:

- Mos harxhoni për ata që vinë pa ftesë, shërbeju atë që e ke gati. Por nëse ti i fton, atëherë mos kurse.

Selmani thotë:

- Resulallahu s.a.v.s., na urdhëroi të mos hyjmë në harxhime për mysafirin, por të shërbejmë atë që kemi.²⁹

Kur Pejgamberin Junus alejhisselam e vizitonin shokët, ai u shtronte bukë elbi dhe pak gjellë me fasule që e bënte vet, duke thënë:

- Hani. Po të mos e kishte mallkuar Allah Teala harxhimin pa nevojë, edhe unë do të harxhohesha e do të përgatisja gjella të ndryshme.

Enes bin Maliku r.a., dhe as'habët e tjerë sillnin para mysafirit atë që kishin; copa buke dhe hurma të thata, duke thënë:

- Nuk dihet kush bën gjynah; ai që përçmon atë me çka gostitet apo ai që përçmon atë që e ka dhe nuk e shërben.

²⁹ Hadithin për ndalimin e harxhimit pa nevojë e shënon Buhariu nga Omer b. Hatabi r.a.

2. Edebi i dytë i takon mysafirit. Mysafiri nuk duhet të zgjedh gjellën dhe t'ia kërkojë atë zotit të shtëpisë, për shkak që kjo mund t'i jetë vështirësi dhe obligim pronarit të shtëpisë. Bile, nëse i zoti i shtëpisë ofron zgjedhje mes dy gjellëve, mysafiri vazhdimisht duhet të preferojë atë që më lehtë përgatitet dhe që është më e lirë. Kjo është sunnet.

E në një hadith thuhet:

“Sa herë që i është propozuar Resulallahut s.a.v.s., të zgjedhë mes dy gjërave, ai vazhdimisht ka zgjedhur më të lirën.”³⁰

A'mesh Ebu Vaili tregon:

“Një ditë, bashkë me një shok vizituam Selmanin. Ai na solli bukë elbi dhe pak kripë. Shoku tha:

- Sikur të na sillje bashkë me kripë edhe pak lisën.

Selmani doli nga shtëpia, e la ibrikun hipotekë, bleu lisën, dhe u kthye në shtëpi. Kur përfunduam ngrënien, shoku tha:

- Hamd Allahut Teala për mirësitë (nimetet), dhe që ishim të kënaqur me pak.

Selmani i tha:

- Po të ishe i kënaqur me pak, ibriku im nuk do të ishte nën hipotekë tani.”

³⁰ Buhariu dhe Muslimi nga Ajsha r.a. (në shënimin e Muslimit qëndron “*deri sa nuk ka gjynah*”)

Këto që i treguam, ndryshojnë varësisht gjendjes së zotit të shtëpisë. Nëse i zoti i shtëpisë ka mundësi të furnizohet dhe nuk do të ketë vështirësi, atëherë nuk ka zarrar të propozohet ushqimi. Kur Imam Shafiu kishte vizituar Zagferanin në Bagdad, kishte kërkuar prej tij lloj-lloj ushqimesh. Zagferani për çdo ditë i jepte hyzmeqarit listën e gjellëve që duhet përgatitur. Një ditë, Imam Shafiu morri listën prej hyzmeqarit dhe i shtoi edhe disa gjella. Kur Zagferani i pa këto gjella në sofër, e qortoi hyzmeqarin, dhe i tha: *“Unë nuk t’i kam shënuar këto në listë!”* Hyzmeqari, i cili ishte skllav, ia tregoi listën me dorëshkrimin e Imam Shafiut, e nga gëzimi, Zagferani e liroi hyzmeqarin.

Ebu Bekr Kettani tregon:

“E vizitova njëherë Sejr Sekatin, ai solli një çorbë me copa të bukës, e derdhi gjysmën në enë, e unë i thashë:

- Çfarë je duke bërë? Të gjithë këtë, unë me një frymë e ha! Sakati, duke qeshur më tha:

- Sinqeriteti yt është më i vlefshëm se sa sevapi i një haxhi.

Disa thonë se ka tri mënyra të ngrënies: me të varfrit - si kujdes ndaj tyre, që ata të hanë më shumë; me shokët - nga gëzimi që jemi me ta; dhe, të ngrënit me njerëzit e dynjallëkut, si shenjë e edebit.

3. Edebi i tretë është inkurajimi i mysafirit në ngrënie, të pyetet çka i pëlqen, e kështu të mundohemi ta kënaqim. Në këtë ka dobi dhe shpërblim. E Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Personit që ushqen vëllain mysliman me atë që ai i kërkon, i falen gjynahet. Kush gëzon vëllain mysliman, ka gëzuar Allahun.”³¹

“Kush ia shijon gojën vëllait musliman me atë që vëllait ia do zemra, Allah Teala ia shënon një milion sevape, ia zhdukë një milion gjynahe, ia lartëson gradën një milion herë dhe e ushqen në tri xhennete: Firdeus, Adn dhe Huld.”³²

4. Edebi i katërt është që mysafiri të mos pyetet për t’i shtruar sofrën. Nëse ka ushqim, e shtron sofrën pa e pyetur. Sevriu ka thënë:

- Kur të vjen shoku në vizitë, është shumë mirë nëse ke mundësi t’i shtrosh sofrën pa e pyetur. Nëse ai nuk ha menjëherë, ngrite sofrën. Por nëse nuk ke nijet për të shtruar sofrën, atëherë nuk duhet as të bisedosh për ushqim dhe as ta tregosh atë.

Sevriu gjithashtu ka thënë:

- Nëse nuk dëshiron të ushqesh fëmijët me atë që ti po ha, atëherë as mos ua trego atë ushqim.

³¹ Bezzari dhe Taberani nga Ebu Derda r.a.

³² Ibnu’l- Xhevzi në ‘**Mevzu**’

Një sufi ka thënë:

- *Kur të ju vizitojë i varfëri - ushqejeni, kur të ju vizitojë dijetari - pyeteni, e kur të ju vizitojë lexuesi i Kur'anit - drejtojeni në mihrab.*

EDEBI I ZIJAFETIT

Zijafeti (gostia) ka gjashtë edebe: 1) ftesën, 2) pranimin, 3) qëndrimin në mexhlis (tubim), 4) shërbimi / shtrimi i sofrës, 5) ngrënia, dhe 6) largimi.

Ne do t'i shpjegojmë këto inshallah, por fillimisht të shpjegojmë vlerën e lartë (fazilet) të zijafetit. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Mos hyni në shpenzime të mëdha për mysafirin; kjo e mërzit atë. Ai që përbuz mysafirin ka përbuz Allahun, e ai që përbuz Allahun, edhe Allahu e përbuz atë.”³³Dhe thotë:

“Nuk ka hair te ai që nuk i gostit mysafirët.”³⁴

Në një rast, Resulallahu s.a.v.s., i bëri vizitë një personi që kishte shumë deve dhe lopë. Ky nuk e shërbeu me ushqim. Më pas, Resulallahu a.s., vizitoi një grua në moshë, e cila kishte disa dele. Gruaja menjëherë e theri një dele për mysafirin e saj, e në këtë Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Shihe këtë; ky ahlak është në dorën e Allahut, e Ai ia dhuron kujt të dëshirojë.”³⁵

³³ Ebu Bekir b. Lal në *‘Mekarimul-Ahlak’* nga Selmani r.a.

³⁴ Ahmed ibn Hanbel nga Ukbe b. Amir r.a.

Skillavi i liruar Ebu Rafi nga Resulallahu a.s., tregon:

- *Një ditë na erdhi një mysafir, e Resulallahu a.s., më tha:*

- Shko te filan çifuti, trego që më ka ardhur mysafiri dhe le të jap pak miell veresie deri në muajin Rexhep.

Çifuti tha se nuk do të jep veresie pa marrë hipotekë. Kur i tregova Resulallahut a.s., ai tha:

- Vallahi, unë jam *emin* (i besueshëm), në qiell dhe në tokë. Po të më jepte veresie do ta paguaja ditën e përcaktuar. Merr këtë mburojë, jepja hipotekë e merre miellin.³⁶

Ibrahimi alejhisselam, në kohën e ngrënies ecte deri në dy milje, duke kërkuar ndonjë mysafir për të ngrënë te ai. Për këtë arsye e kanë quajtur ‘*Baba i mysafirëve*’. Si dëshmi e sinqeritetit të kësaj mikpritjeje, edhe sot e kësaj dite për çdo ditë pranë varrit të tij ushqehen tre deri dhjetë persona, e nganjëherë edhe njëqind. Ata që e mbikëqyrin vendin thonë se asnjëherë nuk ka ndodhur që të kalojë një natë pa mysafirë.

Kur është pyetur Resulallahu s.a.v.s.: “*Çka është ihsan (dashamirësia)?*”, ka thënë:

“Të ushqyerit e të tjerëve dhe dhënia selam secilit.

”³⁷

³⁵ Shënon Haraiti në ‘*Mekarimul-Ahlak*’ nga Ebu’l-Minhali r.a.

³⁶ Is’hak b. Rahuje në ‘*Musned*’, Haraiti në ‘*Mekarimul-Ahlak*’ dhe Ibn Merduje në ‘*Tefsir*’.

³⁷ Buhariu dhe Muslimi nga Abdullah b. Omerit r.a.

E kur është pyetur se si falen gjynahet dhe si arrihen gradat, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Duke ushqyer të tjerët dhe duke falë namaz kur të tjerët janë në gjumë.”³⁸

E kur është pyetur se cili haxh është i vlefshëm, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Të ushqyerit e të tjerëve dhe të folurit e bukur.”³⁹

Enesi r.a., ka thënë:

- Në atë shtëpi ku nuk hyn mysafiri, nuk hyn as melaqja.

Ka edhe shumë hadithe që njoftojnë për vlerën e lartë (fazilet) të zijafetit dhe të dhënies së ushqimit.

EDEBI I FTESES

Personi që fton, duhet të ftojë njerëz të mirë, jo të këqij. Resulallahu s.a.v.s., është lutur për një person:

“Ushqimin tënd le ta hanë të mirët.”⁴⁰

Edhe në një hadith tjetër Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ti haje vetëm ushqimin e të mirëve, e edhe ushqimin tënd le ta hanë vetëm të mirët.”⁴¹

³⁸ Tirmidhi dhe Hakimi nga Muadhi r.a.

³⁹ Hadithi është përmendur në librin për haxh.

⁴⁰ Ebu Davud nga Enesi r.a.

⁴¹ Hadithi është cekë në librin për zekatin.

Posaçërisht duhet ftuar të varfrit, jo të pasurit. Ndërsa Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ushqimi më i keq është gostia dasmore ku nuk ftohen të varfrit, e ftohen vetëm të pasurit.”⁴²

Duhet pasur kujdes në ftesat për akrabatë, dhe të ftohen me radhë, ngase mos-ftesa në tubime të tilla bëhet sepse për urrejtje dhe largim. Ftesa nuk duhet të jetë për t'u dukur në sy të të tjerëve dhe për lavdërim, por për kënaqësi shpirtërore mes vëllezërve myslimanë dhe për të zbatuar sunnetin e Resulallahut s.a.v.s.. Nuk duhet ftuar atë që nuk do të kënaqet e as atë prej të cilit të tjerët nuk do të jenë të kënaqur. Ata që pranojnë ftesën duhet ftuar me kënaqësi.

Sufjani Sevriu ka thënë:

- Të ftohet personi që nuk dëshiron të ftohet është gabim. E nëse ai e pranon ftesën dhe vjen, atëherë bëhen dy gabime.

Kjo sepse ai person është detyruar të hajë pa dëshirë. E ne themi: Duhet ftuar të devotshmin, e jo gjynahqarët. Ngase duke ushqyer të devotshmin ndihmon në ibadetin e tij, e duke ushqyer gjynahqarin, ndihmon në gjynah. Një rrobaqepës e pyeti Ibn Mubarekin:

- Unë qepi rrobat e sultanëve, a mendoni se edhe unë jam ndihmës në dhunën e tyre? Ibn. Mubarek i tha:

⁴² Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

- Jo. Ndihmës është ai që ty të ka shitur gjilpërën dhe perin. Ndërsa ti - ti veç je dhunues.

Pranimi i ftesës është sunnet *muekkede* (sunnet i fortë; i përsëritur), Disa thonë që në raste të caktuara është vaxhib (detyrim; obligim). Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Nëse më ftojnë edhe në Kura (vend afër Tabukut) do ta pranoj ftesën, nëse më dhurojnë një shpatull mish do ta pranoj.”⁴³

EDEBI I PRANIMT TË FTESËS

Janë pesë edebe të pranimit të ftesës:

1. Nuk duhet bërë dallim mes të varfërve dhe të pasurve; nëse pranon ftesën nga të pasurit e nuk e pranon nga të varfrit, një veprim i tillë llogaritet si mendjemadhësi, që është e ndaluar. Shumë njerëz, nga frika e mendjemadhësisë nuk kanë pranuar asnjë ftesë, e disa prej tyre kanë thënë: *“Pritja e çorbës së tjetrit është poshtërim.”* Një tjetër person ka thënë: *“Kur e zgjas dorën në çanak të tjetrit, me këtë vetëm poshtërohem.”*

⁴³ Buhariu nga Ebu Hurejre r.a.

Disa mendjemëdhenj pranojnë vetëm ftesën e të pasurve, e jo edhe të varfërve. Kjo është në kundërshtim me sunnetin, sepse Resulallahu s.a.v.s., ka pranuar ftesën nga të varfrit, bile i është përgjigjur edhe ftesës së skllavit.⁴⁴

Një ditë, Hasan b. Ali r.a., kaloi mbi mushkë pranë disa lypsarëve, të cilët e kishin shtruar sofrën mbi zall dhe po hanin copat e bukës. Hasani r.a. u dha selam, ata e kthyen selamin, dhe thanë: *“O i biri i vajzës së të Dërguarit, urdhëro e ha me neve.”* Hasani r.a., u tha: *“Gjithsesi, Allah Teala nuk i do ata që krenohen”,* dhe zbriti nga mushka e hëngri bashkë me ta. Pastaj hipi në mushkë, u dha selam, dhe tha: *“Unë pranova ftesën tuaj, tani unë po ju ftoj juve.”* Edhe ata pranuan, e pas një kohe të shkurtë shkuan. Hasan b. Aliu r.a., përgatiti gjellët më të shijshme dhe hëngri bashkë me ta.

E sa për fjalët e atij që ka thënë: *“Kur e zgjas dorën në çanak të tjetrit, me këtë poshtërohem”,* sipas mendimit të disave kjo është në kundërshti me sunnetin, por një mendim i tillë është gabim. Nëse ai që fton nuk gëzohet me ardhjen e mysafirit dhe mund ta keqpërdor atë vizitë, atëherë shkuarja edhe bëhet poshtërim. Resulallahu s.a.v.s., ka pranuar ftesat. Ai e dinte që i zoti i shtëpisë do të jetë i kënaqur dhe se për vete do t'i llogaritej një nder. Pra kjo ndërron sipas situatës. Nuk është përshtatshëm sunnetit të pranohet ftesa e atij të

⁴⁴ Tirmidhi dhe Ibn Maxhe nga Enesi r.a.

cilit i vjen vështirë, por fton me pahir, nga zori, ose për t'u lavdëruar. E për mos-pranim të ftesës duhet gjetur arsyetim. Njëri nga sufitet ka thënë:

- Prano ftesën e atij i cili beson se mysafiri ha vetëm riskun e vet, se ajo që të takon ty është vetëm amanet te ai për ta dorëzuar ty; dhe beson se - meqenëse ti pranove amanetin, atij i është bërë mirësi e madhe.

Sejr Sekati ka thënë:

- Kam mall për një kafshatë hallall, në të cilën nuk ka përgjegjësi karshi Allahut, dhe me të cilën nuk hyj në borxh ndaj ndonjë krijese të Allahut.

Prandaj duhet pranuar ftesën nëse mendon se ftuesi është i sinqertë dhe se nuk të bën borxhli. Ebu Turab en- Nabshebiu ka thënë:

- Mu ofrua ushqim, e unë nuk pranova. Katërbëdhjetë ditë pas kësaj mbeta uritur, për shkak se e refuzova ushqimin.

E kanë pyetur Maruf Kerhi-un:

- A shkon ti në çdo ftesë?. Maruf Kehriu u tha:

- Unë jam mysafir; shkoj - e ulem aty ku më thonë.

2. Pozita, varfëria dhe largësia nuk duhet të jenë shkak për refuzimin e ftesës. Një largësi normale nuk duhet të jetë shkak për refuzimin e ftesës. Ndërsa në Tevrat ose në një libër tjetër është thënë:

“Ec një milje për ta vizituar të sëmurin, dy milje për varrim, tri milje për ftesë, katër për të vizituar shokun.”

Po shihet që i është dhënë përparësi ftesës dhe vizitës, sepse obligimi ndaj të gjallëve është më i rëndësishëm se sa obligimi ndaj të vdekurit. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Nëse më ftojnë edhe në Gamim do ta pranoj ftesën.”⁴⁵

Gamim është një vend disa milje larg nga Medina. Një herë, Resulallahu s.a.v.s., arriti aty gjatë Ramazanit, dhe menjëherë bëri iftar⁴⁶ dhe zakonisht atje e shkurtonte namazin.⁴⁷

3. Nuk duhet refuzuar ftesa nëse agjëron (është fjala për agjërim nafile), por duhet të shkojë, e nëse beson që i zoti i shtëpisë do të jetë i kënaqur me ngrënien, duhet ta ndërpres agjërimin, që duke ngrënë ta gëzojë ftuesin. Duhet ta dijë që sevapi nga gëzimi i shokut është më shumë se sa sevapi nga agjërimi. Edhe nëse nuk beson që ftuesi do të gëzohet me ngrënien, duhet ta pranojë insistimin e tij në dukje të sinqertë dhe të hajë. E nëse kupton që insistimi i ftuesit është i rrejshëm, atëherë të gjej arsye e të mos e ndërpresë agjërimin.

⁴⁵ Është cekur më parë.

⁴⁶ Muslimi nga Xhabiri r.a.. Ngjarja ka ndodhur në vitin e çlirimit të Mekës.

⁴⁷ Taberani transmeton nga Ibn Omeri se Resulallahu a.s. e ka shkurtuar namazin në Akik.

Për atë që nuk ka ngrënë duke u arsyetuar se agjëron, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Vëllai yt është munduar, e ti i thua: ‘agjëroj’.”⁴⁸

Ibn Abbasi ka thënë:

- Të ndërpritet agjërimi nafile për ta gëzuar shokun është vlerë e lartë.

Pra, vetëm për të gëzuar shokun, edhe të prishet agjërimi nafile është ibadet dhe ahlak i mirë. Sevapi është më i madh se sa për agjërimin nafile. Nëse ai që agjëron edhe pas tërë insistimit nuk e prish agjërimin, atëherë ai shërbehet me parfum të mirë dhe fjalë të ëmbla.

4. Nuk pranohet ftesa nëse dyshohet që ushqimi, shtëpia a shtroja nuk janë hallall, ose që në sofër mund të gjendet alkool, ose që ushqimi mund të shërbehet me enë argjendi apo në minder mëndafshi, ose vendi është i stolisur me fotografi të njerëzve, ose është tubim me muzikë, zbavitje, thashetheme, kritika, gënjeshtër, shpifje dhe keq-bërje të ngjashme.

Nëse ndonjëra prej këtyre qëndron, ajo është pengesë për pranimin e ftesës. Bile, shkuarja në disa tubime është mekruh, e në disa - haram. Nëse person që fton është mizor, bidatxhi, i korruptuar, dhe ftesën e bën për t'u dukur në sy të të tjerëve, atij nuk i pranohet ftesa.

⁴⁸ Bejhakiu nga Ebu Sad el-Hudri r.a., dhe Darekutni nga Xhabiri r.a..

5. Personi që e pranon ftesën nuk duhet të ketë qëllim mbushjen e barkut, por fitimin e sevapit. Nëse shkon me qëllim të barkut, ai ka shkuar për dynjallëk, e qëllim duhet të jetë shpërblimi në ahiret, pra zbatimi i sunnetit të Resulallahut s.a.v.s., i cili ka thënë:

“Nëse më ftojnë edhe në *Gamim*, do ta pranoj ftesën.”

Duke iu përshtatur kësaj hadithi, zbatohet sunneti.

“Ai që kundërshton ftesën, kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij.”⁴⁹

Përshtatja këtij hadithi largon nga kryengritja.

“Kush gostit vëllain mysliman, ka gostit Allahun.”⁵⁰

Gositja bëhet duke iu përshtatur këtij hadithi.

“Kush gëzon vëllain mysliman, ka gëzuar Allahun.”

Me përshtatje këtij hadithi, pos që e gëzon personin kure fton, duhet bërë nijet që ai edhe të vizitohet, që kështu të bëheni prej atyre që e donë njëri-tjetrin për rizanë e Allahut.

Resulallahu s.a.v.s., ka përcaktuar vizitën e ndërsjellë dhe gostitjen si kusht për t’u bërë prej atyre që e donë njëri-tjetrin për rizanë e Allahut.

⁴⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

⁵⁰ Isfehani, Tergibi dhe Terhibi nga Xhabiri r.a., edhe Ukajli nga Ebu Bekri r.a.

Mos-pranimi i ftesës nuk duhet bërë mundësi për thashetheme si: *“Ai është mendjemadh, i pavirtytshëm.”*

Pranimi i ftesës me cilën do prej gjashtë nijeteve të përmendura, e afron njeriun më shumë Allahut. E si do të ishte sikur të gjitha nijetet të gjenden së bashku?

Njëri nga selefët ka thënë:

- Për çdo veprim timin, bile edhe kur ha e pi, dua të kem një nijet.

Ndërsa Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

"Veprat vlerësohen sipas qëllimeve (nijet). Çdonjërit i takon ajo për të cilën ka nijet. Prandaj, kush shpërngulet (bën hixhret) për shkak të Allahut dhe Të Dërguarit të Tij, shpërngulja e tij është për Allahun dhe Të Dërguarin e Tij. Ndërsa kush shpërngulet të fitojë disa të mira të kësaj bote ose të martohet me ndonjë femër, shpërngulja e tij vlerësohet për atë që është shpërngulur".⁵¹

Nijeti ndikon vetëm në zbatimin e urdhrave të fesë dhe në *mubah*⁵², e nuk ndikon në gjëra të ndaluara nga

⁵¹ Buhariu dhe Muslimi nga Omer b. Hattab r.a.

⁵² **Mubah:** gjërat që nuk kanë as sevap e as gjynah; bërja e një veprimi që nuk ka as gjynah e as sevap.

feja. Për shembull: nëse me nijet për t'i gëzuar shokët i ndihmon ata të pinë alkool ose në ndonjë haram tjetër duke thënë: *“më shpëton nijeti”*, ky nijet nuk i jep dobi as sa grimca dhe në këtë rast *veprat nuk vlerësohen sipas qëllimeve*.

Po ashtu, nëse në betejë, që është një nga ibadetet më të mëdha, shkon duke bërë nijet të fitojë të mira të kësaj bote dhe famë, ky nijet i keq e nxjerr atë betejë prej ibadetit. Do të thotë që nijeti ndikon në zbatimin e urdhrave të fesë, dhe në mubah.

Nëse për në një punë mubah bëhet nijet për mirësi fitohet sevap, e nëse bëhet nijet për të keqe, fiton gjynah. Edhe në ibadet është ngjashëm: nëse nijeti bëhet për rizanë e Allahut - fiton sevap (shpërblehet), e nëse bën nijet për dukje, *rija* dhe të ngjashme - fiton gjynah.

EDEBI I MEXHLISIT (TUBIMEVE)

I ftuari duhet të hyjë në odë me mirësjellje dhe nuk duhet të ulet në krye të odës, por të jetë modest dhe të gjej vend të përshtatshëm. Duhet të shkojë në kohë; jo para kohës, ende pa u përgatitur i zoti shtëpisë, e as pas kohës - që mysafirët të presin. Në odë nuk duhet shqetësuar askënd. Duhet të pranojë të ulet në vendin që i tregon i zoti i shtëpisë, sepse ndoshta ai i ka përcaktuar vendin secilit mysafir, e të kundërshtohet, i priset plani zotit të shtëpisë. Edhe nëse mysafirët tjerë, duke e respektuar ia lirojnë vendet e veta për t'u ulur, duhet të tregoj modesti. Sepse Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Pranimi i vendit më të ulët në mexhlis është modesti për rizanë e Allahun.”⁵³

Nuk duhet të ulet karshi derës së odës së grave. Nuk duhet të shikojë në anën e përgatitjes së ushqimit, sjellja e tillë është grykësi. Personin pranë të cilit ulet, e përshëndet dhe e pyet për gjendjen e tij.

Mysafirët që e kalon natën, i zoti i shtëpisë duhet që para fjetjes t'i tregojë tualetin, vendin ku merret abdesi dhe drejtimin e kiblës. Kështu ka vepruar Imam Maliku kur e kishte mysafir Imam Shafiun.

⁵³ Haraiti në *‘Mekarim-ul Ahlak’*. Ebu Nuajm në *‘Rijazu’l-Mutealim’* nga Tahla b. Ubejd.

Duke i larë duart para mysafirëve, Imam Maliku tha:

- Pa filluar ushqimi, i zoti i shtëpisë duhet t'i lajë duart para mysafirëve, sepse ai gostit. E pas ushqimit, i zoti i shtëpisë i lanë duart në fund, sepse ndonjë mysafir mund të vonohet, e i zoti i shtëpisë ha bashkë me të, prandaj edhe pret deri në fund.

Kur mysafiri mbërrin në vendin ku është ftuar dhe aty sheh diçka të keqe, nëse ka fuqi duhet të intervenojë. E nëse nuk ka fuqi, duke refuzuar me gjuhë atë të keqe, duhet të largohet nga aty. Këto të këqija mund të jenë minderit nga mëndafshi, muret e stolisura me fotografi të njerëzve, enë ari dhe argjendi, muzikë, prania e grave të pa-mbuluara në mexhlis, dhe gjëra tjera që janë haram.

Bile, Ahmed b. Hanbeliu ka thënë:

- Nëse sheh kuti për lyerjen e qerpikëve të përpunuar me argjend, nga ai mexhlis duhet larguar. Nëse sheh perde të holla të përpunuara me argjend ose ari, më mirë është të largohesh nga ajo shtëpi, sepse perdia e përpunuar vetëm për zbulurim nuk mbron nga të ftohtit a të nxehtit, bile as detyrën e mbulimit nuk e kryen. Gjithashtu duhet larguar nëse sheh muret e mbuluara me mëndafsh. Bile, nëse gjen fotografi në shtëpinë ose në hamamin që ka marrë me qira duhet t'i heqë ato, e nëse nuk ka fuqi për këtë, atëherë duhet ta braktisë atë shtëpi.

Imam Ahmedî ka dhënë leje për të qëndruar në shtëpitë ku vetëm shuli i portës është prej argjendit.

Këto fjalë të Imam Ahmedit janë të drejta. Por perdet dhe mëndafshi i varur në mur nuk janë haram në vetvete, haram është vetëm veshja e atij materiali nga meshkujt. Sepse Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Këto (mëndafshi dhe ari) janë haram për meshkujt e ummetit tim, e për gratë janë hallall.”⁵⁴

Por, mëndafshi i varur në mur nuk është zbukurim i mashkullit. Ndoshta më mirë është të thuhet se kjo është mubah. Sepse në ajet thuhet:

Thuaj: "Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që Allahu i krijoi për robët e vet?" 7-Araf: 32

Nuk ka pengesë, përderisa ato nuk përdoren për lavdërim. Nëse thuhet: *“mashkulli merr kënaqësi duke i shikuar këto, prandaj janë haram”*, edhe kjo është gabim; sepse për mashkullin është hallall të shikojë gruan e vet zbukuruar me mëndafsh; e pse të jetë haram nëse shikon mëndafshin e varur në mur?

⁵⁴ Ebu Davud, Nesai dhe Ibn Maxhe nga hazreti Alia r.a.

EDEBI I PËRGATITJES SË USHQIMIT

Edhe këtu ka pesë edebe:

1. Detyra e parë është që ushqimi të shërbehet shpejt. Kjo është gostitje e mysafirit. Resulallahu s.a.v.s., në një hadith ka thënë:

“Ai që beson Allahun dhe ahiretin, le ta gosisë mysafirin.”⁵⁵

Kur të vjen koha dhe shumica e mysafirëve janë mbledhur, sofa duhet të shtrohet, edhe nëse vonohen dy-tre mysafirë. Por, nëse ata të cilët ende nuk kanë ardhur janë të varfër, ose do t’ju thyhet zemra, atëherë mund edhe të pritet.

E Allah Teala thotë:

“A e ke dëgjuar historinë e mysafirëve të nderuar të Ibrahimit?” 51-Dharijat: 24

Në këtë ajet, fjala *‘nderuar’* nënkupton se menjëherë u ka shtruar të hanë, që e shpjegon edhe ajeti në vazhdim:

“Dhe ai pa u vërejtur shkoi te familja e vet dhe solli një viç të majmë të pjekur.” 51-Dharijat: 26

Fjala *“râga”* në këtë ajet domethënë *“shkoi me shpejtësi”*, ose *“shkoi pa u vërejtur”*, e sipas disave,

⁵⁵ Buhariu dhe Muslimi nga Surejxhi.

kuptimi i saj këtu është “solli një kofshë viçl”, kurse shprehja “ixhl” e përdorur në këtë ajet nënkupton që (kofsha) është sjellë me ngutje.

Hatemi Esam ka thënë:

- Ngutja është prej shejtanit, mos-ngutja prej rahmanit. Vetëm në pesë raste ngutja është sunnet, dhe atë, në të ushqyerit e mysafirit, varrosjen e kufomës, martesën e vajzës së pjekur, pagesën e borxhit dhe bërjes teube për gjynahet.

Gjithashtu është e lavdërueshme ngutja për drekën e dasmës. Të shtrohet sofra ditën e parë të dasmës është sunnet, ditën e dytë është adet, e në ditën e tretë është demonstrim në sy të të tjerëve.

2. Ushqimi duhet vendosur me radhë; nëse ka pemë, ato shërbehen të parat, sepse frutat e zbusin stomakun, e kjo është e dobishme edhe nga aspekti mjekësor, pasi që pemët treten më lehtë. Edhe në Kur’ani Kerim, duke respektuar këtë rregull, është thënë:

“Edhe pemë sipas dëshirës së tyre.” 56-Vakia:21

E më pas Allah Teala thotë:

“Edhe mish shpezësh, cilin ta duan.” 56-Vakia:22

Me pak fjalë, pas pemëve është mirë të gostitet me mish dhe tirid.⁵⁶ Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Vlera e Ajshes ndaj grave tjera është si vlera e tiridit ndaj gjellëve tjera.”

⁵⁶Përshesh copash buke me lëng mishi.

E nëse pas të gjithave shërben edhe ëmbëlsira, atëherë janë përmbledhë të gjitha ushqimet e mira. Kur'ani Kerim dëshmon që Ibrahim i a.s., ka gostitur me mish të pjekur (*birjan*) mysafirin, dhe na njofton se kjo është një gostitje e mirë. Pra, duke preferuar ushqimet e mira, Allah Teala thotë:

“Ju furnizua me rrëshirë (të ëmbël) dhe me shkurtëza.” 2-Bekare: 57

Shprehja “*selva*” është përdorur për mishin, pasi që i përfshin edhe ushqimet tjera, dhe atë që e ha, e lehtëson dhe qetëson. Asnjë gjellë nuk mund të zë vendin e mishit. Edhe Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Mishi është mbret i gjellëve.”

Pas përmendjes së rrëshirës dhe shkurtëzave, Allah Teala thotë:

“Hani ushqime të mira me të cilat ju kemi furnizuar!” 2-Bekare:57, e në ushqime të mira llogariten mishi dhe ëmbëlsirat.

Ebu Sulejman Darani r.a., ka thënë:

- *Ngrënia e ushqimit të mirë tërheq rizanë e Allahut Teala.*

E gjithë kjo plotësohet me pirjen e ujit të ftohtë dhe me larjen e duarve me ujë të vakët.

Me'muni ⁵⁷ ka thënë:

- *Pirja e ujit me akull e bën falënderimin ndaj Allahut më të singertë.*

Një shkrimtar ka thënë:

- *Kur i fton shokët, gostiti me fruta dhe borania (me ushqim që tretet lehtë), e nëse u jep edhe ujë të ftohtë, ke plotësuar zijafetin.*

Një i ditur i tha zotit të shtëpisë që e kishte ftuar, dhe kishte shpenzuar shumë për zijafet:

- *Nuk ka pasur nevojë për gjithë këtë harxhim; bukë e pjekur mirë, uthull e fortë dhe ujë të ftohtë do të mjaftonin.*

Edhe një i ditur ka thënë:

- *Më e mirë është një pjatë gjellë e pastaj ëmbëlsira, se sa lloj-lloj ushqimesh. Më e hairit është ngopja me një gjellë, se sa llojllojshmëri gjellësh.*

Është thënë që në sofrën ku ka zarzavate jeshile edhe melekët vinë, e zbukurimi i sofrës me zarzavate jeshile gjithashtu është mustehab. Me një tregim thuhet se në sofrën e cila u zbriti bijve të Israilëve kishte çdo lloj zarzavetesh, përpos purri. Në atë sofër kishte edhe peshk - pranë kokës kishte uthull e pranë bishtit krip, ishin edhe shtatë somuna – në çdo somun nga një ulli

⁵⁷ Me'muni është njëri prej halifeve të Abbasive, dhe është i biri i Harun Rashidit.

dhe nga një kokërr shegë. Zbukurimi i sofrës në këtë mënyrë ia shton njeriut oreksin.

3. Fillimisht duhet shërbyer ushqimin e lehtë, në mënyrë që ata të cilët ashtu donë, të kënaqen me kaq. Është lazdrim dhe veti e dorëshpuarit që së pari të shërbehet ushqimi i fortë, e pastaj ushqimi më i lehtë; kjo ndezë grykësinë dhe është në kundërshtim me sunnetin. Ndër sunnetet e gjeneratës së parë të myslimanëve ka qenë edhe shërbimi i të gjitha ushqimeve përnjëherë në sofër, ashtu që secili ka mundur të hajë atë që i pëlqen, qoftë kjo edhe vetëm një lloj ushqimi. Thuhet se njëri të cilin e zbukuronte njerëzorja i shkruante në letër të gjitha ushqimet që do t'i shërbejë, dhe listën ua prezantonte mysafirëve.

Një shejh tregonte:

- *Kur isha në Sham, Shejhu im më shërbeu me ushqim. Unë i thash që ai ushqim tek ne në Irak shërbehet vetëm në fund të gostisë, e ai më tha: 'Po, ashtu shërbehet edhe këtu në Sham'; më bëri me dije se nuk ka tjetër ushqim për të më shërbyer, e unë u turpërova.*

Një tjetër person, tregonte:

- *Ishim mbledhur disa prej nesh mysafirë, e na shërbyen me koka qengji; të pjekura, e të thara, por ne nuk provuam gjë, duke pritur ndonjë tjetër ushqim, ose mishin tjetër nga qengji. Por, pas një kohe i zoti i shtëpisë na solli legenin për të larë duart, e ne shikuam njëri-tjetrin me habi. Një shejh që ishte prezent, e që i*

pëlqente të na disponojë, tha: 'Allahu është i plotfuqishëm të krijojë edhe koka pa trup.' Ashtu, natën e kaluam të uritur, duke kërkuar edhe ndonjë trohë, sa për të qetësuar urinë.

Prandaj është e dëshirueshme që të gjitha ushqimet të shërbehen menjëherë, ose së paku të lajmërohen mysafirët se çka ka prej ushqimit.

4. Sofra nuk duhet ngritur deri sa të gjithë të përfundojnë të ushqyerit, pra - deri sa ata vetë nuk ngriten nga sofra. Ndoshta dikujt bash kafshatat e fundit i vinë më të shijshme, ose ende ka uri, e me ngutje do të shkaktonim siklet te mysafiri.

Flitet për es-Setturin - ka qenë sufi me shpirt të qeshur ai - se si ka marrë pjesë në një gosti të njërit të dhënë pas dynjasë, e në sofër shtruan qengj të pjekur. I zoti i shtëpisë kishte qëlluar koprrac, e kur sheh se mysafirët po e shqyenin qengjin, urdhëroi shërbëtorin që ta marrë qengjin dhe t'ua dërgojë fëmijëve. Es-Setturi u ngrit dhe u nis pas djaloshit. "*Kah je nisur?!*" e pyetën, e ky u përgjigj: "*Të ha me fëmijët.*" I zoti i shtëpisë u turpërua, dhe urdhëroi që qengji të kthehet.

Pjesë e kulturës islame të të ushqyerit është edhe që i zoti i shtëpisë të mos ngritet nga sofra para të tjerëve, sepse prej kësaj mysafirët turpërohen, dhe ndalin ushqimin. I Zoti i shtëpisë i fundit përfundon së ngrëni. Një njeri shumë i nderuar, mysafirët e vet i njoftonte për secilin lloj të ushqimit që ka, duke i lënë të hanë. Kur vërente se po përfundojnë, do t'ju bashkohej,

e bashkë me bismilah, do të thoshte: *“Hajde, më ndihmoni, Allahu bereqet ju dhashtë.”* Të parët e ndershëm bash kështu kanë vepruar.

5. Ushqim duhet shërbyer aq sa mund të hahet. Të shërbehet pak ushqim është shenjë e mungesës së njerëzores, ndërsa të shërbehet shumë ushqim është lavdërim dhe shenjë e dyfytërisë, sidomos nëse nuk do të hahet e gjitha. Por nëse me plot dëshirë shërben, kjo nuk është dyfytëri, sepse ai me këtë dëshiron bekimin e Allahut për ushqimin e mbetur, përshtatshëm hadithit ku thuhet se për ushqimin që u është shërbyer mysafirëve, nuk jepet llogari.

Tregohet se si Ibrahim ibn Ed’hem shtroi para mysafirëve shumë ushqim, e Sufjani i tha:

- *O Ebu Is’hak, a nuk mendon se kjo mund të jetë harxhim pa nevojë?* Ibrahim iu përgjigj:

- *Ushqimi para mysafirit nuk është harxhim pa nevojë. Megjithatë, pa këtë nijetin tim, ushqimi i tepërt vërtet do të ishte harxhim pa nevojë.*

Ibn Mesudi r.a., thotë:

- *Është e ndaluar shkuarja në gosti, qëllimi i të cilave është lavdërimi.*

Njëjtë, edhe as’habët tjerë këtë veprim e shihnin si të mos-pëlqyer dhe të urryer.

Të themi gjithashtu se nuk ka ndodhur që prej Resulallahut s.a.v.s., të largohet ushqimi i mbetur. Kjo sepse as'habët shërbenin vetëm aq ushqim sa ishte e nevojshme, dhe gjithashtu nuk hanin deri në ngopje.

Qysh në fillim duhet ndarë pjesën për anëtarët tjerë të familjes, që të mos shpresojnë që t'ju kthehet diçka prej ushqimit, e nëse ndodh e nuk ju kthehet, kjo ju vjen rëndë e do të fillonin të flasin fjalë të këqija për mysafirët. Nëse nuk ndahet pjesa për familje, i tilli po i ushqen mysafirët duke përçmuar të tjerët, që do të thotë se në një mënyrë po i tradhton ata.

Mysafirët nuk duhet të marrin me vete atë çka mbetet prej ushqimit. Këtë, sufitë e thërrasin *zillet* (*poshtërsi*), përpos në rastin kur vet i zoti i shtëpisë këtë e kërkon, ose jep shenjë se kjo do ta gëzonte. Vetëm në atë rast mund të merret me vete ajo çka mbetet prej ushqimit, por edhe atëherë duhet pasur kujdes sa merret, varësisht numrit të njerëzve prezent, dhe nevojave të tyre.

EDEBI I LARGIMIT NGA GOSTIA

Kjo ka tri edebe:

1. I zoti i shtëpisë duhet t'i përcjellë mysafirët deri te dera. Kjo është respekt ndaj mysafirit, kurse Resulallahu s.a.v.s., ka urdhëruar:

“Ai që beson Allahun dhe ahiretin, le ta gostisë mysafirin.”

E me një hadith tjetër:

“Përcjella e mysafirit deri te dera është rregull i mirësjelljes dhe sunnet.”

Ebu Katade tregon:

- I erdhën në vizitë Resulallahut s.a.v.s., një delegacion nga Nexhashi, Mbreti i Habeshive (Etiopi). Resulallahu s.a.v.s., filloi vet t'ju bëj hizmet atyre, e kur as'habët e panë këtë, thanë: “O i Dërguari i Allahut, ne bëjmë hizmet, ju uluni. E Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Jo, sepse ata kanë gostitur as'habin tim, e unë dëshiroj që personalisht t'ju kthej të mirën.”

Për të plotësuar respektin ndaj mysafirit, i zoti i shtëpisë duhet që të jetë fytyrëqeshur dhe gojëmbël, prej momentit kur mysafiri mbërrin, përgjatë ndejës, ngrënies në sofër, e deri sa mysafiri të shkojë. Dëshirë e vërtetë e mysafirit është pranimi i mirë, fytyra e qeshur dhe fjala e ëmbël. Edhe Evzai, kur e kanë pyetur:

- Si t'i shprehim respekt mysafirit?, ka thënë:

- Me fytyrë të qeshur dhe me gjuhë të ëmbël.

E Jezid b. Ebu Zijad ka treguar:

- *Sa herë e vizitoj Abdurrahman b. Ebu Lejlanë, më flet bukur dhe më gostit me gjella të shijshme.*

2. Mysafiri duhet të largohet nga gostia duke treguar kënaqësinë, sado që mund të mos i jetë bërë gosti si duhet. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Me ahlak të mirë, personi arrin gradën e atij që ditën agjëron e natën falet (nafile).”⁵⁸

Njëri kishte mësuar me vonesë se është i ftuar në një zifafet, e kur shkon, i zoti shtëpisë e pyeti:

- *Çfarë kërkon?* Personi i tha:

- *Kam qenë i ftuar, vonë e morra lajmin, por erdha.*

- *Mirë, por zifafeti ka mbaruar, tha i zoti i shtëpisë, mysafirët shkuan.*

- *A ka mbetur diçka? Për mua mjafton edhe një copë bukë,* pyeti personi, e i zoti i shtëpisë i tha:

- *Mjerisht jo, nuk mbeti asgjë.* Personi insistoi:

- *Atëherë më sjell tenxheren ku është zier gjella; ndoshta ka mbetur diçka aty, e ta zbrazë.* I zoti shtëpisë tha:

- *Mjerisht, edhe tenxhereja është larë.*

Atëherë, personi tha *‘Elhamdulillah’ dhe u largua.*

Ata që e panë këtë, e pyetën:

- *Çka ishte kjo?, e personi ju tha:*

⁵⁸ Taberani në **‘Kebir’** nga Ebu Uname, dhe Hakimi nga Ebu Hurejre r.a..

- I zoti i shtëpisë më ftoi me nijet të mirë, dhe prapë me nijet të mirë më përcolli, e unë i kënaqur u largova.

Eh, kjo është modesti dhe ahlak i bukur.

Tregohet se një fëmijë e ftoi hoxhën e Xhunejd Bagdadit katër herë në zifafetet e babait. Hoxha secilën herë pranonte, për ta kënaqur fëmijën, e kur shkonte te dera, babai i fëmijës secilën herë e përzinte, e hoxha, duke iu përshtatur dëshirës së babait, kthehej mbrapa.

Të tillët kanë gjetur qetësi në njëshmërinë e Allahut (*tevhid*), janë modest për rizanë e Allahut, pranimin dhe refuzimin nga të tjerët e shohin si provë nga Allahu, nuk dëshpërohen kur dikush i poshtëron, e as nuk gëzohen aq kur dikush i gostitë; duke e ditur që çdo gjë vjen prej Allahut. Për këtë, njëri ka thënë:

- Nuk dëshiroj të pranoj asnjë ftesë të zifafetit, por shkaku i pranimi është se ushqimi atje më përkujton ushqimin e xhenetit. Ushqimi i xhenetit është i mrekullueshëm, e meqenëse ushqimi i zifafetit është pa zahmet dhe për të nuk kërkohet llogari, edhe ai është si ushqimi i xhenetit.

3. Mysafiri duhet të qëndrojë deri sa t'i bëhet qejfi zotit të shtëpisë, dhe nuk duhet të largohet pa e marrë lejen e tij. E për të mos u bërë barrë për zotin e shtëpisë, nuk duhet qëndruar mysafir më shumë se tri ditë.

Edhe Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Tri ditë është mysafirllëk, më shumë se kjo është sadaka.”⁵⁹

Nëse i zoti i shtëpisë singërisht insiston, atëherë mund të qëndrohet më gjatë, e sigurimi i një shtrati për mysafirin, është *mustehab*. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Një shtrat për ty, një për gruan, e një për mysafirin. Më shumë se kaq është për shejtanin.”⁶⁰

⁵⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Shurejh r.a.

⁶⁰ Muslimi nga Xhabiri r.a.

EDEBI QË DUHET RESPEKTUAR, SIPAS SHERIATIT DHE MJEKËSISË

1. Ngrënia në rrugë:

Ibrahim en- Nahai, duke iu mbështetur Resulallahut s.a.v.s., ka thënë:

- *Ngrënia në rrugë është sjellje vulgare*⁶¹, por, Abdullah b. Omeri r.a., transmeton të kundërtën:

- *Në kohën e Resulallahut s.a.v.s., nganjëherë kemi ngrënë duke ecur, dhe kemi pirë ujë qëndruar në këmbë.*

Një sufi i njohur u pa duke ngrënë në rrugë. Kur e pyetën: *“Pse ha në rrugë?”*, u përgjigj:

- O të bekuar, *si mund të pyetni?! Ndjej uri, a duhet të shkoj në shtëpi për ta ngrënë?!*

Disa i thanë: *“Mund të hysh në xhami”*, e ai tha:

- *Më vije turp nga Allahu të hyj në xhami për të ngrënë.*

Këto dy pikëpamje të kundërta mund t'i harmonizojmë kështu:

Adetet ndërrojnë sipas personit dhe ambientit. Edhe ngrënia në rrugë - për disa është shenjë modestie e për të tjerët sjellje e papëlqyeshme dhe jonjerëzore.

⁶¹ Taberani nga Ebu Uname. Gjithashtu Ibn Atije në *‘Kamil’*, edhe nga Ebu Uname edhe nga Ebu Hurejre.

2. Këshillat e hazreti Alisë r.a.:

Alia r.a., ka thënë:

- *Ai që fillon me krip ushqimin, Allah Teala i largon nga ai shtatëdhjetë derte.*

- *Ai që çdo ditë i ha nga shtatë hurme, në stomak i zhduket çdo parazit.*

- *Ai që ha çdo ditë njëzet e një kokrra rrush të thatë, nuk ndjen pengesë në trup.*

- *Mishi shton mishin. Tiriti është gjellë Arabe. Supa e pulës zgjeron stomakun dhe rrit kërcin.*

- *Mishi i lopës është sëmundje, qumështi dhe yndyra e saj janë shërim.*

- *Ngrënia e paktë heq yndyrën e brendshme dhe sëmundjet.*

- *Ushqimi më i dobishëm për lehonën është hurma e freskët.*

- *Peshku dobëson, dhe rrit energjinë.*

- *Leximi i Kur'anit dhe përdorimi i misvakut e zhduk këlbazin.*

- *Kush dëshiron jetë të gjatë duhet të hajë kafjall herët, darkë të hajë pak, të mos ec këmbëzbathur, të pakësojë marrëdhëniet intime me gruan dhe të ketë sa më pak borxh.*

3. Rekomandimet e mjekut për Haxhaxhin:

Haxhaxhi i tha mjekut:

- *Më rekomando veprime, që t'ju përmbahem, e mjeku i tha:*

- *Nëse martohesh, merr vajzë të re. Ha mish تازه. Zieje mirë gjellën. Mos përdor barëra pa u sëmurë. Ha fruta të pjekur. Ushqimin përtype mirë. Ha atë ushqim që të pëlqen. Mos pi ujë duke ngrënë, lëre për fund. Mos vono urinën dhe jashtëqitjen; urina është si lumi që del nga shtrati dhe dëmton. Kur ha drekën, ec së paku njëqind hapa, e pastaj edhe fli pak.*

Edhe arabët kanë këtë shprehje:

“Ha kafjall e shtriju, ha darkë e ec”.

4. Ngrënia para se të dilet nga shtëpia:

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Prerja e damarëve shkakton sëmundje, e prerja (lënia) e darkës shkakton jetëgjatësi.”⁶²

Arabët thonë: *“Braktisja e darkës shkrinë yndyrën e kofshëve.”*

⁶² Ibn Atije në *‘El-Kamil’* nga Abdullah b. Xherad-i pjesën e parë të hadithit, kurse pjesën e dytë e transmetojnë Tirmidhiu nga Enesi r.a., dhe Ibn Maxhe nga Xhabiri r.a.

Një i ditur, e kishte këshilluar djalin:

- *O bir, mos dil prej shtëpisë pa ngrënë kafjallin, sepse kjo të bën të drejtë dhe serioz, dhe nuk të lejon të lakmosh çdo gjë që sheh në çarshi.*

E një i ditur tjetër, duke aluduar, i tha një personi të trashë:

- *Kush të qëndisi kadifenë në shpinë, si e realizove?*, e personi i tha:

- *Duke ngrënë bukë të bardhë e mish keci, duke u lyer me shebojë dhe duke veshur rroba pambuku.*

5. Regjimi i ushqimit:

Disa thanë: *“Përmbajtja nga ushqimi (pehriz) është e dobishme për të sëmurin, por e dëmshme për të shëndetshmin.”*

E disa të tjerë thanë: *“Përmbajtja nga ushqimi është e rrezikshme dhe sigurisht që ndikon në shëndet. Por, i shëndetshmi duhet ta respektojë.”*

Transmetohet se Resulallahu s.a.v.s., e pa Suhejbin r.a., me dhimbje në sy, e duke ngrënë hurme, dhe i tha:

“Si ha hurme kur ke dhimbje në sy?”

Suhejbi i tha:

- *O Resulallah (s.a.v.s.), po ha nga ana e shëndoshë, e Resulallahu s.a.v.s., qeshi.*

6. Dërgimi i ushqimit familjes së të vdekurit:

Të dërgohet ushqim në shtëpinë e të vdekurit është e lavdërueshme (mustehab). Kur erdh lajmi që vdiq Xhafer b. Ebu Talibi, Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Familja e Xhaferit është e zënë me vdekjen e tij, e nuk kanë kohë të mendojnë për përgatitjen e ushqimit. Prandaj dërgoni ushqim.”

Është sunnet që tri ditë t’i dërgohet ushqim familjes së të vdekurit. E prej ushqimit që vjen në shtëpi, çdokush mund ta hajë. Por, ushqimi që përgatitet për vajtueset nuk hahet, dhe atë ushqim nuk janë të obliguar ta përgatisin familjarët e të vdekurit.

7. Zijafeti i mizorit:

Nuk është e drejtë të shkohet në zijafet të mizorit, por nëse je i detyruar, atëherë duhet të hash vetëm pak. Bile, një kadi nuk e ka pranuar as dëshminë e personit që kishte shkuar në zijafetin e sulltanit. Personi tha se ka qenë i detyruar të shkojë në atë zijafet, e kadia i tha:

- Por unë të pashë si e zgjate dorën në gjellët më të mira dhe merrje kafshatat e mëdha, e për këtë nuk ke qenë i detyruar.

Pas një kohe, i njëjti sulltan e detyroi në ushqim edhe këtë kadi, duke i thënë: *“ha prej kësaj gjelle”*, e kadia i tha:

- Nëse ha, më duhet të braktis detyrën e kadisë. E pasi që sulltani nuk kishte kadi tjetër, e la lirë.

Tregohet se Zunnuni Misriu ishte burgosur. Ai nuk hëngri asgjë për disa ditë, e kur e dëgjoi këtë një motër besimtare, i dërgoi përmes rojës ushqimin që e kishte fituar me punë dore. Misriu prapë refuzoi, e motra besimtare e pyeti:

- *Pse refuzove? Unë të dërgova ushqim prej fitimit hallall.* Zunnuni Misriu, duke bërë shenjë kah duart e rojës, tha:

- *E dija që ushqimi është hallall, por erdhi në duart e zullumqarit.*

Qe, ky është veprim nga shkalla e fundit e devotshmërisë!

8. Shija e mirë e ushqimit:

Tregohet se Fetih Musliu i kishte shkuar në vizitë Bishri Hafijes. Bishri ia dha një dërrhem hyzmeqarit të tij Ahmed Xhelalit, dhe i tha:

- *Shko blej bukë dhe ushqim të shijshëm.*

Ahmedi tregon:

- *Unë morra bukë dhe përkujtova hadithin e Resulallahut s.a.v.s. për qumështin:*

“O Allah! Bëje këtë qumësht bereqet për ne, dhe shtona riskun.” Prandaj morra edhe qumësht dhe hurma të shijshme.

Fetih Musliu vetë hëngri, tepricën e morri me vete, dhe shkoi. Pas kësaj, Bishri tha:

- A e di pse thash të blesh ushqim të shijshëm? Sepse ushqimi i shijshëm është shkak për falënderim të singertë. A e di pse mua nuk më ftoi në ushqim? Sepse mysafiri nuk e fton të zotin e shtëpisë. A e di pse e mori me vete tepricën? Sepse, kur është tevekkuli i vërtetë, nuk ka zarar të merret ushqimi me vete.

Ebu Ali er- Ruzbariu (Allahu qoftë i kënaqur me të) me një zijafet i ndezi njëmijë kandilë. Dikush i tha:

- Ky është harxhim i kotë, e Ebu Alia i tha:

- Shiko brenda; nëse gjen një kandil që nuk është ndezur për rizanë e Allahut por për demonstrim, atë shuaje. Personi hyri brenda, por nuk gjeti asnjë kandil që do të mund ta shuante.

Ebu Ali er-Ruzbariu një herë bleu shumë sheqer, e dërgoi në ëmbëltore, dhe kërkoi që me atë sheqer t'i bëjnë një ndërtesë. Pastaj i thirri dervishët dhe ata e hëngrën ndërtesën prej sheqerit.

KËSHILLAT E IMAM SHAFIUT RRETH USHQIMIT

Ngrënia e ushqimit është në katër mënyra:

1. Ngrënia me një gisht është edukatë;
2. Ngrënia me dy gishta është kryelartësi;
3. Ngrënia me tre gishta është sunnet; dhe
4. Ngrënia me katër a pesë gishta është grykësi.

Katër gjëra përforcojnë trupin:

1. Ngrënia e mishit;
2. Parfumi i mirë;
3. Larja e shpeshtë, edhe pa qenë xhunub; dhe
4. Rrobat e pambukta.

Katër gjëra dobësojnë trupin:

1. Marrëdhëniet e shpeshta seksuale;
2. Brengat e shumta;
3. Pirja e shumtë e ujit në stomak të zbrazët; dhe
4. Ngrënia e shumtë e thartirës.

Katër gjëra forcojnë dritën e syrit:

1. Ulja drejt Kiblës;
2. Lyerja e qerpikëve (surme) para gjumit;
3. Shikimi i ngjyrës së gjelbër; dhe
4. Veshja e rrobave të pastra.

Katër gjëra dobësojnë dritën e syrit:

1. Shikimi në pisllëk;
2. Shikimi në njeriun e varur;
3. Shikimi në mitër;
4. Ulja me shpinë kthyer kah Kibla.

Katër gjëra shtojnë marrëdhënien seksuale:

1. Mishi i harabelit;
2. *Itrifili ekber* (ilaç i përbërë nga disa substanca;
bot. *Menyanthes trifoliata*);
3. Fëstëku; dhe
4. Magdanozi.

Katër llojet e gjumit:

1. Shtrirja në shpinë. Ky është gjumi i Pejgamberëve. Të shtrirë në këtë mënyrë, ata mendojnë rreth krijimit të tokës dhe qiejve.
2. Shtrirja në anën e djathtë. Ky është gjumi i dijetarëve dhe njerëzve të rëndomtë;
3. Shtrirja në anën e majtë. Ky është gjumi i sulltanëve. Kjo lehtëson tretjen; dhe
4. Shtrirja në stomak, e ky është gjumi i shejtanit.

Katër gjëra shtojnë zgjuarsinë:

1. Braktisja e të folurit të shumtë e të panevojshëm;
2. Përdorimi i misvakut;
3. Shoqërimi me të singertit; dhe

4. Shoqërimi me dijetarët.

Katër gjëra llogariten ibadet:

1. Të jesh vazhdimisht me abdes;
2. Të bësh shumë sexhde;
3. Të qëndrosh sa më shumë në xhami; dhe
4. Të lexosh sa më shumë Kur'an.

Imam Shafiu e ka thënë edhe këtë:

- Çuditem si nuk vdes ai që hyn në hamam i uritur, e kur del nuk ha. Çuditem edhe si nuk vdes ai që sapo të ketë dhënë gjak, menjëherë ha.

Dhe gjithashtu ka thënë:

- Ilaçi më i dobishëm për sëmundjen e murtajës është meneksheja.

E Allahu e di të vërtetën.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
EDEBI I TË NGRËNIT VETËM.....	5
EDEBI PARA NGRËNIES	5
EDEBI GJATË NGRËNIES.....	11
EDEBI UJIT.....	13
EDEBI PAS NGRËNIES.....	15
EDEBI E NGRËNIES RRETH SOFRËS.....	17
EDEBI I GOSTITJES	23
EDEBI I MYSAFIRIT	26
EDEBI I MIKPRITËSIT	29
EDEBI I ZIJAFETIT	35
EDEBI I PRANIMT TË FTESËS.....	39
EDEBI I MEXHLISIT (TUBIMEVE).....	47
EDEBI I PËRGATITJES SË USHQIMIT	50
EDEBI QË DUHET RESPEKTUAR, SIPAS SHERIATIT DHE MJEKËSISË	62
KËSHILLAT E IMAM SHAFIUT RRETH USHQIMIT	69

